

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

PALA DHURUESE:

Z. Rogers Veizi qytetar shqiptarë, lindur në Elbasan, i datëlindjes 17.02.1999, rezident në Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr.pasaporte: BI3051330 dhe Nr. Personal ID: J90217059J madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut me 5% të kapitalit të shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k.

PALA PRANUESE E DHURIMIT:

z. Ali Koceku, lindur në Erseke, me 09.03.1958, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit ID BJ8679664 me nr. Dhe Nr. Personal F803090380, **ne cilësinë e ortakut me 55% të kapitalit të shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në QKB me NUIS M41827023I, me adresë Rr."Rahman Sina", Nr.pasurie 41/101 Zona Kadastrale Nr. 2679 vol 39, fq. 230, Mezez, Tiranë.

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noter/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Kushte paraprake:

1. Pala dhuruese, z. Rogers Veizi, është ortak i shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k. dhe zotëues i një kuote me 5% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.
2. Z. Rogers Veizi ka vendosur të kryejnë dhurimin e kuotes me 5% pjesëmarrje në kapitalin që zoteron pranë shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k.
3. Z. Ali Koceku deklaron se pranon dhurimin e kuotes të shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k në masën 5% duke u shndërruar nga ortak me një kuote prej 60% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.
4. Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "CCC Solar" sh.p.k. me anë të vendimit të datës 05.11.2024 ka vendosur miratimin e transferimit të kuotes së z. Rogers Veizi që përben 5% të kapitalit të shoqërisë nepermjet dhurimit në favor të z. Ali Koceku.

Neni 1- Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil;
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Neni 2 - Objekti i kontrates



Objekt i kesaj kontrate eshte dhurimi i kuotes ne shoqerine "CCC Solar". Z. Roger Veizi zoteron 1 kuote me 5% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise "CCC Solar".

Nepermjet kesaj kontrate, dhuruesi, nga e drejta qe i lindin si ortak i shoqerise "CCC Solar", heq dore nga kuota e tij prej 5% pjesmarrje ne shoqeri duke i kaluar keto te drejta sipas kesaj kontrate ne favor dhe pronesi te znj. Ali Koceku.

Neni 3- Dhurimi

Dhurimi i kuotes si mesiper nga ortaku ekzistues z. Rogers Veizi ne favor te ortakut tjetër z. Ali Koceku do te behet pa kundershperblim apo detyrim tjetër ligjor,

Me nenshkrimin e kesaj kontrate z. Rogers Veizi nuk do te jete me ortak i Shoqerise, nderkohe qe pranuesi i dhurimit z. Ali Koceku do te shnderrohet ne ortakun e vetem:

- **Z. Ali Koceku – ortake dhe zoteruese e nje kuote me 60% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise "CCC Solar" sh.p.k.**

Neni 4- Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Çdo lloj mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj kontrate, do te zgjidhet me mirekuptim ndermjet paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 5– Te ndryshme

Për sa më sipër, z. Ali Koceku, pranon dhurimin e kuotes me masen 5% te kapitalit te shoqerise, me te gjitha te drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur në momentin e dhurimit dhe do te lindnin ne vazhdim si pasoje e zoterimit te kuotes, perfshire detyrimet ndaj institucioneve shteterore (tatim mbi vleren e shtuar, tatim mbi te ardhurat, tatim ne burim, taksat dhe tarifat vendore, sigurimet shoqerore, sigurimet shendetesore, gjobat dhe kamatvonesat, faturime nga OSHEE dhe UKT etj.); ndaj punëmarrësve (pagat dhe cdo detyrim i cili rrjedh nga ligji dhe kontrata e punes); ndaj te treteve, shoqeri tregtare dhe person fizik (cdo e drejte\ detyrim i cili rrjedh nga kontrate qiraje, sherbimi, enfitoze, leasing, kredi , huaje etj.) apo cdo e drejte\ detyrim ndaj shoqerive tregtare dhe\ ose organizate jo-qeveritare brenda dhe jashte territorit shqiptar ku Shoqeria "CCC Solar" shpk eshte ortak\ anëtar, perfshire cdo te drejte\ detyrim i cila nuk eshte permendur shprehimisht ne kete kontrate dhe ne menyre ligjore ose\ dhe kontraktuale i takon shoqerise "CCC Solar" shpk Brenda mases se kuotes qe zoteron.

Me nenshkrimin e ketij akti, pala dhuruese deklaroi dhe pranon se nuk ka dhe nuk do te kete asnje pretendim as tani as ne te ardhmen ndaj perfitueses se dhurimit dhe asnje pretenim financiar dhe jo vetem ndaj subjektit "CCC Solar" shpk dhe ndaj pranueses se dhurimit.

Palet bien dakord qe depozitimi i aplikimit perkates per regjistrimin e kalimit te pronësisë ne regjistrin tregëtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te Biznesit, do te kryhet brenda 7 diteve nga nënshkrimi i kesaj kontrate.

Kontrata u lexua qartë në prani të palëve, të cilët deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje noteres.

Kontrata u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlera të njëjta juridike mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese.

Unë noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALA DHURUESE

PALA PRANUESE E DHURIMIT

z. Rogers Veizi

Rogers Veizi

Z. Ali Koceku

Ali Koceku